



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit

Projektvendimi “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjektet e rregulluara dhe të rregullores “për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga instalimet, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektvendimi ka si qëllim përafrimin e plotë me parashikimet e Rregullores zbatuese të Komisionit (BE) 2018/2066, datë 19 dhjetor 2018 mbi monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë në zbatim të Direktivës 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me shkarkimet e GES-eve nga sektori i instalimeve (industriale/prodhuese), sektori aviacionit civil dhe sektori i mbuluar nga subjekti i rregulluar që është sektori i lëndëve djegëse të hedhura për konsum dhe të përdorura për djegie në sektorët specifikë të përcaktuar në Shtojcën II, Pjesa D e Ligjit nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, i ndryshuar si transportit rrugor, ndërtimit, ngrohjes rezidenciale, prodhimit të energjisë etj., duke rregulluar elementet e mëposhtëme që mungonin në legjislacionin shqiptar:

- Përcaktimin e procedurave dhe kushteve të posaçme për marrjen e autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjekti i rregulluar ;

- Përcaktimin e rregullave, procedurave dhe metodologjive specifike për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga instalimet, aviacioni civil dhe subjekti i rregulluar;
- Përcaktimin e rregullave, procedurave dhe metodologjive specifike për monitorimin dhe raportimin e efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO2 nga operatori avionit.

Nëpërmjet të gjitha rregullimeve të mësipërme, projektvendimi synon dhe garanton zbatueshmërinë në periudhën afat shkurtër të sistemit të monitorimit dhe raportimit të shkarkimeve të GES në Republikën e Shqipërisë në përputhje të plotë me sistemin MR të BE-së të rregulluar nga aktet e sipërpërmendura, duke rritur si rrjedhojë edhe transparencën dhe përgjegjshmërinë në veprimtaritë me ndikime klimatike.

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, projektvendimi i është nënshtruar procesit të konsultimit publik në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”.

Konsultimi publik është hapur në datë 21.1.2026 dhe është mbyllur në datë 16.2.2026 në përputhje me afatin minimal prej 20 ditësh pune të parashikuar nga ligji nr. 146/2014.

Gjatë kësaj periudhe, palët e interesuara, përfshirë institucionet publike, operatorët ekonomikë, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët, kanë pasur mundësi të paraqesin komente, sugjerime ose vërejtje mbi projektvendimin dhe dokumentacionin shoqërues.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metoda e përdorur për konsultim, të projektvendimit “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjektet e rregulluara dhe të rregullores “për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të

gazeve me efekt serrë nga instalimet, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”, ishte nëpërmjet publikimit në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, nga data 21.1.2026 deri në 16.2.2026.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Ky projektvendim është hartuar nga Drejtoria për Ndryshimet Klimatike pranë Ministrisë së Mjedisit, me mbështetjen e asistencës teknike të projekteve SANECA – Legal (GIZ), Ekspertët e Komunitetit të Energjisë dhe Tratolow.

Në kuadër të hartimit të projektvendimit është konsultuar gjithashtu Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektvendimi “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjektet e rregulluara dhe të rregullores “për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga instalimet, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂” ka regjistruar 349 shikime në RENJK dhe asnjë koment.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i	Komenti (grumbulloni dhe përmblidhni komente identike/të ngjashme	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që	Vendimi (I pranuar/I	Justifikimi
--	---	--	----------------------	-------------

ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	adresuan çështjen në mënyrë ngjashme)	pranuar pjesërisht/I refuzuar)	